

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	E 'forta e Çapjave' goditi gazetarin Artan Hoxha dhe vëllanë e Vis Korçarit. 'Doktoresha gangstere' Rozalinda Nallbati dorëzohet pasi dhunoi Elton Qynon. Gjyqtari Altin Abdiu i heq njëren masë sigurie
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/08/e-forta-e-capjave-goditi-gazetarin-artan-hoxha-dhe-vellane-e-vis-korcarit-doktoresha-gangstere-rozalinda-nallbati-dorezohet-pasi-dhunoi-elton-qynon-gjyqtari-altin-abdiu-i-heq-njeren-mase-sigurie/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:36:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 15:13:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f8eb3f37fb3352738d08def1bb632a59096d9636cd4d45dd015459c5d57f0e24
TEKSTI	59e95875c54ec57c00a55ee1c5c276f59345463160f56a55b3c66ecd3e8dfdf0
PAMJA	ee2795991147332d9418469259f50ad299bae15d3b25d4083037f2a8e414e661

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a1ec67716e20b30c76ff5e97a8acbdb7b9fdb980aed1cb97926e9a3f2ec6b03
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njëren nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a1ec67716e20b30c76ff5e97a8acbdb7b9fdb980aed1cb97926e9a3f2ec6b03>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

E 'forta e Çapjave' goditi gazetarin Artan Hoxha dhe vëllanë e Vis Korçarit. 'Doktoresha gangstere' Rozalinda Nallbati dorëzohet pasi dhunoi Elton Qynon. Gjyqtari Altin Abdiu i heq një rën masë sigurie

Investigim

Publikuar: 08/09/2026

f X



Për gati 25 ditë me rradhë, Rozalinda alias Rosela Nallbati, (mbesa e ish-Drejtorit të Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit, Neritan Nallbati dhe e forta e grupit kriminal "Çapja" në Elbasan), dyshohet se qëndroi e fshehur në zonën e "Oxhakut" në Tiranë, për t'u vetëparaqitur më pas në ambjentet e komisarariatit Nr.6 në Tiranë.

Sipas një njoftimi të Policisë së Tiranës, ajo ishte shpallur në kërkim qysh prej datës 30 korrik 2026, për shak se ndaj 33-vjeçares ka filluar një çështje penale në prokurorinë e Tiranës, për akuzën e "Goditjes për shkak të detyrës", pasi qëlloi qëlloi me telefon gazetarin e Kronikës së Zezë, Elton Qyno.

Por e "forta" e "Çapjave" me profesion Mjeke, vendosi të dorëzohet në ambjentet e komisarariatit Nr.6 në Tiranë, pasi ishte informuar se gjyqtari i Tiranës, Altin Abdiu, kishte vendosur ndaj saj dy masat e sigurisë "Ndalim i daljes jashtë shtetit", "Detyrim paraqitje pranë OPGJ" dhe njëherësh kishte urdhëruar prokurorinë ti bllokonte pasaportën kësaj doktoreshe.

Në fund të muajit Gusht 2026, Rozalinda Nallbati, u paraqit para gjyqtarit Altin Abdiu, duke kërkuar heqjen e masave të sigurisë dhe lejimin për të dalë jashtë shtetit, pasi pretendoi se ka dy fëmijë të vegjël dhe i duhej ti rregjistronte në shkollë në Dubai.

Përmes nevojës për shkollimin e fëmijëve, Rozalinda, bindi

Me te lexuarat

Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e

Ramat, Besnik...

Besnik Leskaj i mori në punë të birin. Postet

në merrshmi i

Berati / Si a

Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik

Rokalli qadiga e

Ramën në Arbitrazh: Po

na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë

biznesmenit

Enri, ri, borxhi i vjetër: si lind

ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

gjiqtarin Altin Abdiu, të ndryshojë masën e sigurisë duke i hequr “Ndalimin e daljes jashtë shtetit” dhe lënë në fuqi masën e “Detyrimit për tu paraqitur pranë oficerit të policisë gjyqësore. Pavarësisht kësaj, çështja penale kundër saj vijon të jetë e hapur dhe ndaj Rozalinda alias Rosela Nallbatit, po kryen hetime për veprën penale të “Goditjes për shkak të detyrës” në dëm të gazetarit Elton Qyno. E gjithë ngjarja ndodhi në ambjentet e Spitalit Amerikan në Tiranë.

Por rasti me gazetarin Elton Qyno nuk është i izoluar. Rozalinda Nallbati rezulton të ketë pasur dhe precedentë të tjerë të kësaj natyre me veprime të dhunshme, presione psikologjike dhe kërcënime.

Një burim pranë policisë së Tiranës kujtoi se mbesa e Neritan Nallbatit, Rozalinda Nallbati, të njëjtin incident ka bërë dhe me gazetarin e njohur, Artan Hoxha. Rasti është regjistruar para disa kohësh në ambjentet e një lokali pranë zonës së “Kinostudios”, kur në lokal është shfaqur Rozalinda Nallbati, së bashku me një femër tjetër.

Ajo ka sulmuar fizikisht gazetarin Artan Hoxhën dhe ka lëshuar sharje dhe ofendime drejt tij. Skena është parë nga klientët e tjerë të lokalit, por vetë gazetari për incidentin në fjalë, nuk ka bërë kallëzim penal në polici.

Doktoresha, që tashmë është natyralizuar në “të fortën” e Elbasanit dhe Tiranës, pasi xhaxhin, Neritan Nallbati, e kishte Drejtor të Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit dhe burrin Florenc Çapjan e ka të dënuar me burgim të përjetshëm, mendon se i bie kujdo njeriu në rrugë, në lokal, në servis dhe në spital etj.

Rozalinda Nallbati ka precedent tjetër të dhunimit dhe dëmtimit të pronës, rast i cili sipas burimeve të policisë është regjistruar rreth muajit Maj 2026 në qytetin e Elbasanit.

E forta e “Çapjave” këtë rradhë ka sulmuar Raif Çaušllarin, vëllain e Elvis Çaušllarit që në Elbasan njihet si “Vis Korçari” aktualisht në burg, shok i ngushtë i Florenc Çapjas dhe Bledar Muçës.

Raif Çaušllari, ndodhej në ambjentet e servisit të tij në rrugën “Çerçiz Topulli” në Elbasan, ku ka ngritur një biznes të vogël familjar për shitjen dhe riparimin e motorave elektrikë dhe me benzinë. Por në këtë biznes është shfaqur me makinë Rozalinda Nallbati, duke i dëmtuar disa motorë që i kishte nxjerë për reklamim shitje dhe njëherësh, ka sulmuar me fjalë fyese dhe duke e quajtur “Tradhtar” të vijës kriminale të grupit “Çapja”, Raif Çaušllarin dhe vëllain e tij, “Vis Korçarin”.

Sipas burimeve të policisë edhe në këtë rast, Raif Çaušllari, nuk u paraqit në polici për të bërë denoncim, megjithëse ju dëmtuan disa motorë nga goditja me makinë që i bëri doktoresha Rosela Nallbati. Por kjo ngjarje kujtohet shumë mirë në Elbasan dhe për më tepër edhe policia është informuar për rastin në rrugë

operative.

TAG:

Artan hoxha

Dhune

elton qyno

Florenc çapja

Neritan nallbati

Rozalinda Nallbati

Vis korçari

Të ngjashme

Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Pacolli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izraelit Ron Yeffet

Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administratë të djalit të kryebashkiakut të Shkodrës, si i pa...

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.